



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Misioni në Kosovë

Analizimi i gjendjes - Shërbimi për Zjarrfikje dhe Shpëtim në Kosovë



Raporti Final

Nga ekspertët e CTIF-së

Z. H. Herweg
Gjermani

Z. T. Forsberg
Suedi

Z. P. Hofman-Bang
Danimarkë

Z.. Dr. P. Wagner
Gjermani

Shkurt 2008

1. Hyrje:

Në fund të vitit 2007 Departamenti për Siguri Publike pranë OSBE-së e ftoi ekipin e përbërë nga katër ekspert për zjarfikje dhe shpëtim, të rekomanduar nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zjarfikje dhe Shpëtim (CTIF) që të bëjnë një hulumtim/analizë të thukët lidhur me Shërbimin për Zjarfikje dhe Shpëtim në Kosovë duke e përfshirë këtu edhe Departamentin për Menaxhimin e Emergjencave.

Ky raport është produkt i ekspertëve zjarfikës pranë CTIF-së dhe përmban një përmbledhje të përgjithshme të dhënave dhe rekomandimeve, propozimin për implementimin e rekomandimeve dhe në fund vizionin për të ardhmen e shërbimit për zjarfikje dhe shpëtim në Kosovë.

Është vërejtur nga ana e ekspertëve të CTIF-së që edhe në të kaluarën janë bërë vlerësime të gjendjes së shërbimit për zjarfikje dhe shpëtim në Kosovë por që këto vlerësime nuk kanë shpjeguar në ndryshime drastike. Në emër të OSBE-së Misionit në Kosovë dhe CTIF-së, ekspertët singërisht shpresojnë që Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave do ti shfrytëzojë të dhënat dhe do ti koordinojë përmirësimet e qëndrueshme në brigadat zjarfikëse të Kosovës. Nevojat janë të mëdha dhe populli i Kosovës i kërkon këto përmirësime.

Përmbajtja

	Lënda	F.
1.	Hyrje.....	2
2.	Fjalori.....	3
3.	Përmbledhje.....	3
4.	Metodologjia.....	3
5.	Vizioni për shërbimin për zjarfikje dhe shpëtim në Kosovë.....	4
6.	Të dhënat e përgjithshme dhe rekomandimet.....	5
6.1.	Stacionet për zjarfikje dhe shpëtim.....	5
6.2.	Zonat e reagimit/rreziqet.....	6
6.3.	Personeli.....	6
6.4.	Pajisjet mbrojtëse personale (PMP).....	6
6.5.	Ndërtesat e shërbimit për zjarfikje dhe shpëtim	7
6.6.	Automjetet e shërbimit për zjarfikje dhe shpëtim.....	8
6.7.	Aktivitet operative.....	10
6.8.	Trajnimet.....	11
6.9.	Rreziqet.....	12
6.10.	Buxheti.....	12
6.11.	Rregulloret.....	13
6.12.	Bashkëpunimi me agjensionet tjera të sigurisë publike në Kosovë.....	14
6.13.	Të ndryshme.....	14
7.	Propozimet për implementim.....	17
8.	Lista e anekseve.....	17
9.	Shënimet për autorin	18

2. Fjalori

CTIF:	Asociacioni ndërkombëtar për zjarrfikje dhe shpëtim
DME:	Departamenti për menaxhimin e emergjencave
MATREZ:	Materialet e rrezikshme
TMK:	Trupat mbrojtëse të Kosovës
SHPK:	Shërbimi policor i Kosovës
OSBE:	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë
PMP:	Pajisjet mbrojtëse personale
ATR:	Aksidentet e trafikut rrugor

3. Përmbledhje

- Shërbimi për zjarrfikje dhe shpëtim, për momentin nuk është në gjendje që në mënyrë të kënaqshme ti plotësojë përgjegjësit e veta në shpëtimin e jetërave dhe pasurisë së qytetarëve të Kosovës.
- Zjarrfikësit në Kosovë paguhen më pak në krahasim me zyrtarët e shërbimit policor të Kosovës. Ata nuk kanë sigurim ndaj aksidenteve në punë. Kjo i demotivon zjarrfikësit.
- 50 përqind e të gjithë automjeteve të shërbimit për zjarrfikje dhe shpëtim kanë defekte teknike që e kufizon përdorimin në mënyrë të konsiderueshme. Ndërsa 36 përqind e të gjitha automjeteve nuk janë funksionale.
- Donacionet duhet ti përfillin nevojat e Kosovës. Ekspertët mendojnë që duhet të vendosen standardet për donacione dhe do të ishte përparësi nëse donacionet do të koordinoheshin nga ekspertët e një asociacioni vendor apo ndërkombëtar.
- Shumë pak nga brigadat për zjarrfikje dhe shpëtim bëjnë trajnime të rregullta me standarde të arsyeshme. Lokacionet për këto trajnime thuaj se nuk ekzistojnë.
- Për momentin Qendra e Trajnimit për zjarrfikje dhe shpëtim në Vushtrri/Vuçitër nuk i ofron të gjitha trajnimet e nevojshme për shkak të mungesës së lokacioneve trajnuese të specializuara për shuarjen e zjarreve, planë programeve, pajisjeve dhe personelit kompetent. Fatmirësisht Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim mbështet Qendrën e Trajnimit me administrim të kurseve, klasë, hapësira trajnuese, mjete ndihmëse, ushqim dhe konvikte.
- Shumë e brigada zjarrfikëse nuk marrin fondet e dedikuara për ta.
- Ka dallime të mëdha në mes të ligjit të aplikueshëm dhe realitetit.
- Kalimi i brigadave zjarrfikëse nën administrimin e komunave në vitin 2004, thjeshtë ka dështuar dhe kjo ka rezultuar me një gjendje jo të barabartë në terren dhe me ndarjen jo adekuate të fondeve për brigadat zjarrfikëse në të gjithë Kosovën
- Mungojnë standardet e alarmimit dhe procedurat komanduese gjatë një incidenti.
- Brigadat për zjarrfikje dhe shpëtim duhet që nga administrimi komunal të transferohen në administrim qendror nacional me një strukturë të centralizuar siç janë shërbimi policor, apo doganat dhe shërbimi korrektues.

4. Metodologjia

Dy ekipe të CTIF-së së bashku me ndihmën e përkthyesve nga OSBE-ja kanë vizituar 29 stacione të shërbimit për zjarrfikje dhe shpëtim të Kosovës, duke e përfshirë këtu qendrën për trajnime të shërbimit për zjarrfikje dhe shpëtim në Vushtrri/Vuçitër dhe qendrën për shpërndarjen e informacioneve në Prizren/Prizren. Brigadat zjarrfikëse në Leposavić/Leposaviq dhe në veri të Mitrovicë/Mitrovica refuzuan që të përfshihen në këtë analizë. Disa komuna kanë përkrahje sa i përket shërbimeve zjarrfikëse edhe nga komunat fqinje. Brigada zjarrfikëse e Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës është përgjegjëse për komunën e Obiliq/Obilić. Kjo sqaron se pse disa komuna nuk e kanë shërbimin për zjarrfikje dhe shpëtim të vetin. Hulumentuesit u takuan edhe

me drejtorin e Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave (DME)¹ në Prishtinë/Priština. Përfaqësuesit e DME-së ishin të ftuar që të marrin pjesë në këto vizita, dhe në disa raste e shfrytëzuan këtë mundësi.

Ekspertët e CTIF-së intervistuan komandantët e 29 stacioneve zjarrfikëse. Në disa raste edhe zyrtarë të ndërrimit ishin prezent gjatë intervistave. Poashtu në disa raste edhe zyrtari për parandalim të zjarrit dhe/ ose Drejtori i Drejtoratit për Mbrojtje Civile pranë komunës ishin prezent. Kështu raporti është i bazuar në informatat e marra gjatë intervistave si dhe vëzhgimet e bëra ndërtesave, pajisjeve dhe automjeteve. Në asnjërën nga vizitat bërë stacioneve zjarrfikëse ekspertët nuk patën mundësi që të shikojnë brigadat zjarrfikëse në aksion apo duke kryer ushtrime. Të dhënat për secilin stacion mund të gjenden në Anekse, të cilat përbëjnë bazën e raportit. Shifra shtesë u ofruan nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Ekspertët e CTIF-së siguruan informata të mjaftueshme dhe të duhura që u mundësuan atyre përpilimin e rekomandimeve në raport.

5. Vizioni për shërbimin për zjarrfikje dhe shpëtim

Vizioni i ekspertëve është që brenda pesë deri tetë vite, shërbimi për zjarrfikje dhe shpëtim i Kosovës mund të arrijë një standard të njëjtë me standardin e ofruesve të tjerë të sigurisë publike në Kosovë, siç janë shërbimi policor, shërbimi doganor dhe shërbimi korrektues.

Kjo nënkupton,...

...që shërbimi për zjarrfikje dhe shpëtim në Kosovë:

- është i organizuar në atë mënyrë që të ofroj shërbim të mirë dhe efikas ndaj qytetarëve;
- është i përgatitur për aksidente ku përfshihen materialet e rrezikshme;
- çdo vit publikon statistika të sakta nga brigadat zjarrfikëse në lidhje me kohën e përgatitjes.

...që çdo stacion për zjarrfikje dhe shpëtim në Kosovë të ketë:

- menaxhment kompetent;
- automjete zjarrfikëse të mjaftueshme të një standardi të arsyeshëm si dhe një automjet komandues për udhëheqësin e incidentit;
- pajisje të nevojshme për situata të ndryshme;
- garazhe të ngrohura për të gjitha automjetet;
- hapësirë të mjaftueshme për personel, deponim, mirëmbajtje dhe riparim të pajisjeve;
- qasje në mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, si dhe riparim të pajisjeve të veçanta;
- qasje në ndërrim të përkohshëm të automjeteve;
- qasje në poligone ushtruese me pajisje adekuate;
- personelin e nevojshëm me kualifikime relevante dhe paga të krahasueshme me pjesëtarët e SHPK-së, shërbimit korrektues etj;
- qasje në plan programet relevante, edukim dhe njohuri;
- vullnetarë me pajisje themelore në fshatrat përkatëse;
- fonde të mjaftueshme për të lartë shënuarat.

...që qendra e trajnimeve për zjarrfikje dhe shpëtimin në Vushtri/Vučitrn të:

- ofroj kurse relevante në sasi të mjaftueshme;
- ketë automjete trajnuese dhe pajisje të domosdoshme;

¹ Drejtor, Bislim Zyrapi

- ketë objekte trajnuese të domosdoshme, përfshirë këtu edhe poligonet trajnuese, garazhe dhe klasë;
- ketë stafin trajnues të nevojshëm me kualifikim adekuat;
- përpilohj/prezantohj plan programe për veten dhe brigadat zjarrfikëse;
- ketë fonde të mjaftueshme për të lartë shënuarat.

6. Të dhënat e përgjithshme dhe rekomandimet

Kjo pjesë përmban komponentin më të madh të këtij studimi. Secili komponent shkurt është i përshkruar dhe i përcjellur nga rekomandimet përkatëse të ekspertëve të CTIF-së.

6.1 Stacionet për zjarrfikje dhe shpëtim

Këto stacione janë të lokalizuara në qendër të komunave përkatëse, afër rrugëve kryesore. Disa nga stacionet janë ndërtuar rishtazi. Numri dhe lokacioni i këtyre stacioneve mbulon tërë territorin e Kosovës.

Nr.	Të vizi tua ra	Komuna	Moshë							Mesat arja	Sasia totale
			>20	20-25	26-30	31-40	41-50	51-60	>60		
1	x	Deçan / Deçane								27	5
2	x	Dragash / Dragaš								35	18
3	x	Gjakovë / Đakovica	0	6	25	8	3	8	0	35	50
4	x	Glogovc/Glogovac								30	17
5	x	Gjilan/Gnjilane								42	31
6	x	Istog/Istok								27	8
7	x	Kaçanik / Kačanik								40	16
8	x	Kamenicë / Kamenica								33	24
9	x	Klinë / Klina								40	17
10	x	Fushë Kosovë / Kosovo Polje								27	6
11	x	Lipjan / Lipljane	0	1	3	13	3	0	0	35	20
12	x	Malishevë / Mališevo								35	18
13	x	Mitrovicë / Mitrovica pjesa jugore								35	24
14	x	Novobërdë / Novo Brdo								35	5
15	x	Rahovec / Orahovac								35	20
16	x	Pejë / Peç								35	36
17	x	Podujevë / Podujevo	0	1	0	15	2	0	0	35	18
18	x	Prishtinë / Priština 1								35	134
19	x	Prishtinë / Priština 2	0	0	7	11	9	2	0	35	29
20	x	Laplje Selo / Llapllasellë	0	3	2	16	4	1	0	35	26
21	x	Prizren / Prizren								27	31
22	x	Skenderaj / Srbica								27	18
23	x	Štrpce / Shtërpçë								35	11
24	x	Shtime / Štimlje								35	8
25	x	Suharekë / Suva Reka								35	16
26	x	Ferizaj / Uroševac	0	0	6	13	4	13	7	45	43
27	x	Viti / Vitina								35	23
28	x	Vushtrri / Vuçitrn								30	31
29	x	Zubin Potok / Zubin Potok								30	20
30	-	Mitrovicë / Mitrovica pjesa veriore								të pad	të padisp.
31	-	Leposavić / Leposaviq								të pad	të padisp.
Numri i përgjithshëm i zjarrfikësve											723

Fig. 1: Shpërndarja e zjarrfikësve për stacione

Rekomandim: Ekspertët e CTIF-së nuk vlerësuan mbulueshmërinë gjeografike të stacioneve përkatëse. Në të ardhmen çështja duhet vëzhguar nga DME-ja, bazuar në analizat e raporteve të vlefshme dhe gjykimet nga personeli i stacionit zjarrfikës. Ekspertët e CTIF-së mbështesin strategjinë e vendosjes në qytete të mëdha të disa stacioneve të vogla zjarrfikëse në vend të një stacioni të vetëm të madh.

6.2 Zonat reaguese/rreziqet

Për të gjitha stacionet zjarrfikëse, zona reaguese përfshin komunën përkatëse që ndonjëherë është një territor mjaftë i gjerë.

Rekomandim: Analiza e rrezikut duhet kryer në secilën komunë, gjë e cila kërkohet edhe me ligj si bazë për planin e përgjithshëm emergjent.

6.3 Personeli

Në stacionet zjarrfikëse janë të punësuar kryesisht profesionistët, disa zyrtarë me gjysmë orar dhe disa punonjës vullnetarë. Standardi për punë është 12 ose 24 orë për ndërrim për 1 deri në 15 zjarrfikës. Motivimi i personelit në përgjithësi duket të jetë mjaft i ulët. Dhe besohet se arsyet kryesore për këtë janë pagat e ulëta dhe kushtet e vështira financiare të ofruara nga komunat. Poashtu edhe vetë personaliteti i komandantëve të stacionit ka rëndësi të madhe në motivim.

Rekomandim: Përmirësim të disiplinës dhe mënyrës së sjelljes në punë në baza ditore për zjarrfikësit. Njëkohësisht rritjen e pagave për zjarrfikësit në nivel të njëjtë me zyrtarët e shërbimit policor të Kosovës. Ekspertët e CTIF-së rekomandojnë që shkathtësitë e zjarrfikësve të vlerësohen me kujdes para rekrutimit të tyre dhe mund të jetë e nevojshme përfundimi i kontratës i disa zjarrfikësve meqë duket se këta zyrtarë nuk kanë fare motivim dhe kompetencë për kryerjen e punës. Në lidhje me mungesën e zjarrfikësve në brigadat zjarrfikëse në Kosovë, Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave duhet të ofroj një standard minimal ku definohet numri dhe funksioni i zjarrfikësve për secilën brigadë zjarrfikëse. Lidhur me këtë çështje ekspertët e CTIF-së rekomandojnë:

- minimumin e 6 zjarrfikësve për automjet zjarrfikës,
- minimumin e 4 zjarrfikësve për automjetin sulmues zjarrfikës,
- minimumin e 1 zjarrfikësi për cisternë zjarrfikëse,
- minimumin e 2 zjarrfikësve për shkallë ajrore,
- minimumin e 4 zjarrfikësve për njësi shpëtimi.

6.4 Pajisjet mbrojtëse personale (PMP)

Pajisjet mbrojtëse personale për zjarrfikësit, të përbëra nga xhaketat, helmetat, pantallonat, çizmet, dorëzat dhe maskat për frymëmarrje ekzistojnë në sasi të pamjaftueshme dhe janë siguruar nga donacionet. Ekziston mungesë e të gjitha pajisjeve por posaçërisht e maskave për frymëmarrje (shih Fig. 2). Në përgjithësi PMP-të ishin në gjendje të mirë. Çuditërisht këto pajisje treguan pakës shenja të përdorimit të tyre. Ekspertët e CTIF-së nuk kanë vërejtur erën tipike të tymit, e cila zakonisht haset në stacionet për zjarrfikje dhe shpëtim dhe në pajisjet e tyre. PMP-të janë shumë të ftohta gjatë dimrit. Në shumë stacione zjarrfikëse u la të kuptohet që aftësia mbrojtëse nga zjarri e rrobave/pajisjeve pakësohet pas 5 viteve. Ekspertët e CTIF-së nuk e ndajnë të njëjtin mendim. Aparatet për frymëmarrje të cilat u hasën në shumicën e stacioneve duket se nuk janë aq të shfrytëzueshme. Në disa stacione u hasën stoqe të çizmeve të reja, helmetave etj. Për zjarrfikësit vullnetarë pothuajse nuk ekzistojnë PMP-të.

Rekomandim: Duhet blerë të gjitha PMP-të të cilat mungojnë, po ashtu edhe për zjarrfikësit vullnetarë. Të gjithë zjarrfikësit duhet detyruar që ti veshin dhe ti përdorin ato.




Fig.2: Tregon mungesat e përgjithshme të PMP-ve në brigadat zjarrfikëse të Kosovës e posaçërisht mungesat e maskave të frymëmarrjes.

6.5 Ndërtesat për shërbimin zjarrfikës dhe të shpëtimit

Këto janë garazhe të vjetra në përgjithësi, të mirëmbajtura dobët, të ngrohura në mënyrë jo të përshtatshme dhe me hapësira të pamjaftueshme për ti garazhuar të gjitha automjetet zjarrfikëse. Ndërtesat në disa vende janë të mira sa i përket standardit. Gjatë dimrit disa automjete duhet të mbushen me ujë në mënyrë që stacioni zjarrfikës të mund t'i përgjigjet ndonjë thirrje për shkak se automjetet nuk mund të mbrohen nga ngrica.

Rekomandim: Një studim i thellë i nevojave hapësinore duhet të kryhet. Kjo duhet të shpie tek renovimi dhe në disa raste edhe në konstruktimin e stacioneve të reja zjarrfikëse. Stacionet me një standard të mirë mund të bëhen model për rikonstruktimin e stacioneve tjera. Izolimi i mureve, dritareve dhe dyerve duhet të bëhet pasi që kjo do t'i zvogëlonte shpenzimet e nxehtësisë. Personeli në dhomat tjera nuk duhet detyruar që të thith tymin e kamionëve zjarrfikës. Sipas informatave të dhëna, një stacion i arsyeshëm mund të ndërtohet me një çmim prej 70.000 Euro. Me një investim prej dy milionë eurosh stacionet zjarrfikëse do të shndërrohen në një standard të duhur. Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave duhet të riorganizoj numrin e tanishëm të stacioneve zjarrfikëse. Një plan afatmesëm dhe afatgjatë duhet të përpilohet në bashkëpunim me brigadat zjarrfikëse përkatëse, në atë mënyrë që numri ekzistues i stacioneve brenda zonës së përgjegjësisë të brigadës zjarrfikëse të jetë i riorganizuar.

Ekspertët e CTIF-së rekomandojnë strategjinë vijuese:

- Stacionet kryesore zjarrfikëse (stacionet me automjete dhe pajisje për zjarrfikje themelore e të avancuar dhe ndihmë teknike) do të themeloheshin si Shtabe Operative në qytete të mëdha;

- Stacionet zjarrfikëse (stacionet me automjete dhe pajisje për zjarrfikje themelore e të avancuar dhe ndihmë teknike) do të themeloheshin si qendra për operacione zjarrfikëse dhe shpëtuese në qytete të vogla.
- Degët e stacioneve zjarrfikëse (stacionet me automjete dhe pajisje vetëm për zjarrfikje themelore) do t'i kryejnë operacionet zjarrfikëse dhe shpëtuese në fshatra;
- Përpilimin e koncepteve planifikuese rreth numrit dhe strukturës komanduese si dhe themelimin e qendrave kontrolluese për vitin e ardhshëm;
- Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave duhet të zhvilloj një plan për krijimin e stacioneve të reja zjarrfikëse dhe të shpëtimit brenda vendit;
- Stacionet e reja duhet të planifikohen me standardet minimale (dhomat, pajisjet, mirëmbajtja, kushtet e punës).

6.6 Automjetet e shërbimit për zjarrfikje dhe shpëtim

Metodologjia: Ekspertët e CTIF-së kryen një vlerësim përmbljedhës të gjendjes së këtyre automjeteve dhe pajisjeve në secilën stacion zjarrfikës të vizituar (shih, aneksin 30). Secili automjet ishte vlerësuar sipas shkallës së kategorisë prej 1 deri 5, duke marrë parasysh gjendjen teknike të automjeteve, ndërtimin e automjetit zjarrfikës, cilësinë dhe sasinë e pajisjeve teknike për zjarrfikje, shërbimin e shpëtimit dhe operacionet me materiet e rrezikshme-kimike.

Lista e kategorive:

Kategoria 1:	Të gatshëm për përdorim
Kategoria 2:	Të gatshëm për përdorim por me defekte të vogla dhe të mesme,
Kategoria 3:	Të gatshëm për përdorim por me defekte të konsiderueshme,
Kategoria 4:	Të gatshëm për përdorim vetëm pas riparimeve,
Kategoria 5:	Të papërdorshme,

Sipas standardit evropian, disa automjete të kategorisë 2 dhe të gjitha automjetet e kategorisë 3, 4 dhe 5 do të duhej të largoheshin nga shërbimi.




Fig. 3: Klasifikimi i numrit të automjeteve sipas kategorive

Gjendja e automjeteve:

- 13 përqind e automjeteve janë të përdorshme pa kufizime (kategoria 1). Kryesisht këto janë automjete zjarrfikëse turke të dhuruara nga Shtetet e Bashkuara si dhe disa automjete Britanike.
- 50 përqind e automjeteve kanë defekte teknike, që e kufizojnë përdorimin në mënyrë të konsiderueshme (kategoritë 2 dhe 3);
- 36 përqind e automjeteve nuk janë funksionale (kategoritë 4 dhe 5). Në disa stacione, ekspertët e CTIF-së nuk i kanë vlerësuar në tërësi disa automjete zjarrfikëse të prishura nga ndryshku dhe jo operuese të parkuara në hapësirat e stacioneve zjarrfikëse;
- Mesatarja e përdorimit të automjeteve është rreth 30 vite;
- Vërehet mungesa e shkallës me plato rrotulluese në regjionet ku ato janë të nevojshme në saje të numrit të ndërtesave të larta;
- Shumica e pajisjeve janë me defekte ose mungojnë fare;
- Pajisjet që përdoren gjatë aksidenteve ku përfshihen materiet e rrezikshme fare nuk janë në dispozicion.

Konkluzionet:

Shërbimi zjarrfikës dhe i shpëtimit nuk mund t'i përmbush detyrat për shpëtimin e jetërave dhe pasurisë së qytetarëve të Kosovës për shkak se:

- Numri dhe cilësia e automjeteve në dispozicion është e pamjaftueshme;
- Në disa regjione, reagimi me kohë i shërbimeve përkatëse zjarrfikëse në rast të zjarrit, të aksidenteve në trafikun rrugor dhe ndodhive tjera nuk është i mundshëm;
- Reagimi i duhur dhe profesional në aksidentet ku përfshihen materie e rrezikshme është i pamundshëm për shërbimin për zjarrfikje dhe shpëtim në Kosovë;

Më tej ekspertët e CTIF-së kanë vërejtur se pothuajse të gjitha stacionet zjarrfikëse janë të pajisura me aparate mjaft të reja të frymëmarrjes, pajisjeve hidraulike dhe me radio. Ndonëse duket se këto pajisje nuk mirëmbahen në mënyrë të duhur. Mungesa e mirëmbajtjes sa i përket aparateve të frymëmarrjes është shqetësuese pasi që rrezikon jetërat e zjarrfikësve. Pajisjet hidraulike duken të jenë përdorur shumë rrallë. Ekspertët e CTIF-së kanë vërejtur mungesë të përgjithshme të pajisjeve në automjetet zjarrfikëse, edhe pse në disa raste është janë të pranishme brenda stacioneve (p.sh. fiskaja/zorrë të reja).

Rekomandimet: Secili stacion zjarrfikës duhet të jetë i pajisur me automjete zjarrfikëse të një cilësie të kënaqshme. Automjetet zjarrfikëse me defekte duhet të riparohen dhe pajisjet që mungojnë duhet blerë në mënyrë që automjetet zjarrfikëse të jenë të pajisura me pajisje të nevojshme. Automjetet jo funksionale duhet të largohen.

Në të shumtën e rasteve një reagues i parë dhe një kamion cisternë do të jetë i përshtatshëm. Shkallët me ngritje të lartë janë të nevojshme në qytetet me ndërtesa të larta, pra një shkallë duhet të vendoset në stacionin kryesor të secilit regjion. Sugjerohet zbatimi i të njëjtit standard për gypat (fiskajat) çifte dhe pajisjet tjera zjarrfikëse në tërë Kosovën. Kjo do ta lehtësoj mirëmbajtjen dhe blerjen.

Një vendim në nivel qendror duhet bërë në lidhje me sasinë e nevojshme (blerje, largim, zëvendësim), llojet dhe karakteristikat (madhësi, shkalla me platformë rrotulluese, pajisjet speciale, furnizimi me ujë) e automjeteve zjarrfikëse për secilin stacion të shërbimit zjarrfikës në Kosovë. Ekspertët e CTIF-së propozojnë shkëmbimin e pothuajse të gjitha automjeteve me automjete të dorës së dytë të një standardi të mirë e që mund të përdoren në Kosovë. Është mendim i ekspertëve të CTIF-së se në një shumë prej dy milionë eurosh do të jetë e mundur që të

blihen 30 pompa, 30 cisterna dhe 10 automjete me shkallë rrotulluese dhe plato, të dorës së dytë, 5 deri 10 vite të përdorura. Ekspertët e CTIF-së rekomandojnë se këto automjete duhet të jenë sa më të ngjashme që është e mundur, 10-20 përqind e këtyre automjeteve duhet shfrytëzuar si automjete rezervë në rast të prishjes së ndonjë automjeti zjarrfikës. Automjetet më të mira zjarrfikëse duhet shfrytëzuar si automjete rezervë. Një organizatë qendrore e logjistikës duhet të themelohet. Shërbimet zjarrfikëse dhe shpëtuese duhet të pranojnë donacione të një standardi të arsyeshëm, i cili përshtatet me nevojat dhe standardet e shërbimit zjarrfikës dhe shpëtues të Kosovës. Duhet krijuar një sistem i mirëmbajtjes në mbarë Kosovën për pajisjet zjarrfikëse, përfshirë në të pompat zjarrfikëse, gypat për ujë, radiot, maskat e frymëmarrjes dhe aparatet e frymëmarrjes.

6.7 Aktivitetet operative

Sipas ekspertëve të CTIF-së sistemi i thirrjes i shërbimit për zjarrfikje dhe shpëtim në Kosovë kërkon përmirësim të fortë. Numri telefonik i Emergjencës është i ndryshëm prej regjionit në regjion. Në disa zona, qytetarët mund ta thërrasin drejtpërdrejt brigadën zjarrfikëse, ndërsa në zonat tjera duhet që nëpërmes policisë të kontaktohet shërbimi zjarrfikës. Kur policia nuk mundet të kontaktoj brigadën zjarrfikëse ata e dërgojnë një veturë patrulluese tek stacioni zjarrfikës. Përveç kësaj, ekspertët e CTIF-së erdhën në përfundim se bashkëpunimi gjatë aksidenteve të mëdha ka nevojë për përmirësim, meqenëse nuk është sistematikisht i organizuar.




Fig. 4: Aktivitetet kryesore operative të shërbimit për zjarrfikje dhe shpëtim në Kosovë

Rekomandimet: Një sistem efikas i standardit të thirrjes ndërkombëtare përfshirë këtu edhe teknologjinë dhe metodologjinë duhet të instalohet. ‘Përkrahja strategjike’ duhet të zhvillohet dhe të zbatohet për të gjithë shërbimin zjarrfikës në mbarë Kosovën, kështu që brigadat e ndryshme të jenë në gjendje që në mënyrë të duhur të bashkëpunojnë gjatë aksidenteve të mëdha. Duhet krijuar procedurat standarde operative për rastet emergjente ku janë të përfshira materiet e rrezikshme. Në këtë rast rekomandohet përfshirja e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK-së). Njësia për Mbrojtje Civile e TMK-së duhet ti kryesoj të gjitha aksidentet ku përfshihen materiet e rrezikshme,

përderisa organizimi, pajisjet dhe shkathtësitë e shërbimit për zjarrfikje dhe shpëtim të kenë arritur nivelin e nevojshëm të kapacitetit për këtë lloj të situatës emergjente.

6.8 Trajnimet

Shumica e zjarrfikësve e kanë vijuar kursin e trajnimit themelor. Shumica e zjarrfikësve profesional po ashtu kanë vijuar kursin profesional. Trajnimi i ndihmën së parë është vijaur deri në një shkallë të caktuar. Shumë pak stacione zjarrfikëse kryejnë trajnim të një standardi të pranueshëm. Objektet për një trajnim të tillë nuk ekzistojnë. Po ashtu duket se zjarrfikësit nuk kanë informata të përgjithshme rreth pajisjeve dhe mirëmbajtjes së tyre. Shumë komandantë të stacioneve pohuan në lidhje me mbajtjen e trajnimeve, ushtrimeve dhe testimeve të zakonshme ditore në stacionet e tyre. Ekspertët e CTIF-së e patën të vështirë për tu besuar këtyre informacioneve, meqenëse mungesa e planeve trajnuese, mungesa e objekteve trajnuese dhe ushtrimeve praktike, si dhe mirëmbajtja e dobët e pajisjeve ishin kundërtë të deklaratat e komandantëve të stacioneve.




Fig. 5: Komandantët e stacioneve zjarrfikëse u kërkuan që të numërojnë nevojat trajnuese. Tabela tregon rezultatet e fituara.

Qendra e trajnimit për zjarrfikje dhe shpëtim në Vushtrri/Vučitrn:

Opinionet në lidhje me qendrën e trajnimit për zjarrfikje dhe shpëtim radhiten nga kënaqësia e plotë deri në kritikën e thellë rreth kapacitetit të ultë dhe mungesës së personelit kompetent. Është opinion i ekspertëve të CTIF-së, se qendra e trajnimit nuk ofron shërbime të nevojshme për brigadat zjarrfikëse. Qendrës i mungojnë ambientet/objektet për trajnim, pajisjet dhe personeli kompetent. Ekziston një laborator i forenzikës i modelit Rus, i cili është jashtë përdorimit për shkak të mungesës së personelit kompetent. Ekzaminimet e zjarrit kryhen nga një kombi lëvizës laboratorik.

Rekomandimet:

Në lidhje me trajnimin në stacione:

- Të gjithë zjarrfikësit duhet të kenë trajnime të rregullta.
- Trajnerët edhe zyrtarët e stacionit duhet të jenë të përgjegjshëm në lidhje me pastrimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve.

Sa i përket trajnimit qendror në qendrën e trajnimit në Vushtrri/Vuçitrn:

- Pajisjet për trajnim, p.sh. automjetet zjarrfikëse, cisternat, shkallët me plato rrotulluese duhet të jenë të standardit më të mirë, në mënyrë që trajnerët të jenë në gjendje të punojnë me automjetet në stacionet përkatëse komunale;
- Duhet siguruar literatura për zjarrfikje;
- Qendra e trajnimit për zjarrfikje dhe shpëtim në Vushtrri/Vuçitrn duhet të zhvilloj të gjitha plan programet lidhur me trajnimin për zjarrfikje dhe shpëtim, në mënyrë që ky plan program të përdoret për trajnim në qendër dhe për trajnime lokale në stacionet zjarrfikëse;
- Zjarrfikësit e Kosovës kanë nevojë të ndjekin trajnim themelor në lidhje me materiet e rrezikshme, të kenë pajisje mbrojtëse dhe edukim në nivel regjional;
- Kapaciteti trajnues duhet siguruar përfshirë klasat për mësim, kontejnerët 'flashover' (shkrepje e menjëhershme), në mënyrë që të simulohet/ushtrohet 'flashover' i drejtpërdrejtë dhe 'shtëpia e zjarrit'. Të gjitha objektet duhet të pajisen me rrymë elektrike dhe me ujë.
- Të përmirësohet qendra e trajnimit në Vushtrri/Vuçitrn me klasë për mësim, objekte më të mira për deponim dhe me një punëtori me kompresor.
- Të përmirësohet menaxhimi i burimeve njerëzore në lidhje me numrin e personelit dhe kualifikimet e tyre, si dhe në lidhje me trajnerët dhe udhëheqësit e tyre. Zjarrfikësit e kualifikuar dhe me përvojë nga terreni duhet të ligjërojnë në qendrën e trajnimit në Vushtrri/Vuçitrn për të përmirësuar bashkëpunimin në mes të qendrës dhe stacioneve zjarrfikëse.
- Vendosija e një bashkëpunimi më të ngushtë me Qendra Trajnuese për zjarrfikje dhe shpëtim nga vendet tjera.
- Rekomandohet bashkimi i laboratorit të papërdorshëm të forenzikës me laboratorin e forenzikës së policisë ose me një institut tjetër teknik. Kjo do të siguronte që pajisjet e vlefshme të përdoren në mënyrë efikase.
- Të sillen zyrtarë kompetent për zjarrfikje dhe shpëtim nga vende tjera në cilësi të ekspertëve, në mënyrë që të punojnë në stacionet përkatëse së paku një muaj. Këta zyrtarë do të sillnin përvojat e tyre dhe do të prezantonin procedurat e trajnimit dhe mirëmbajtjes.

6.9 Rreziqet

Ekspertët e CTIF-së kuptuan që zjarrfikësit e Kosovës kryesisht janë të aftë që të merren me zjarrfikje të zakonshme dhe aksidente të trafikut rrugor. Megjithatë, ekziston mungesë trajnimi ose përvoje sa i përket ndërtesave të larta, zjarreve në pyje dhe vërshimeve. Përveç kësaj, zjarrfikësit e Kosovës nuk kanë njohuri rreth transportimit të mallrave të rrezikshme, ku përfshihen materiet kimike, biologjike, radiologjike dhe nukleare, po ashtu edhe shpëtimin nga uji dhe malet.

Rekomandimet: Ekspertët e CTIF-së këshillojnë shërbimin për zjarrfikje dhe shpëtim në Kosovë që të përgatitet për këto rreziqe meqë zhvillimi industrial ka të ngjarë që shumë shpejt të merr hov të madh të zhvillimit. Zjarret në pyje kanë sfiduar forcat në 2007 dhe nëse turizmi zhvillohet në Kosovë, shpëtimi në male do të bëhet një element i rëndësishëm i detyrës ditore. Bashkëpunimi ndërkombëtar mund të jetë përparësi në këtë fushë.

6.10 Buxheti

Zjarrfikësit marrin paga të ulëta. Kjo vërehet veçanërisht kur pagat e tyre krahasohen me pagat e zyrtarëve të shërbimit policor të Kosovës. Kjo është shumë de-motivuese për zjarrfikësit e sidomos për faktin që ata nuk paguhen për punën e bërë gjatë ndërrimit të natës. Ekspertët e CTIF-së kanë mësuar se shumë brigada zjarrfikëse nuk marrin fondet e ndara për ta, për shkak të keq menaxhimit në komunën përkatëse. Zjarrfikësit nuk janë të siguruar.

Rekomandim: Ekspertët e CTIF-së kanë rekomanduar që të rriten pagat e zjarrfikësve dhe që buxheti i ndarë duhet të shfrytëzohet nga brigadat zjarrfikëse. Duhet të instalohet një mekanizëm i kontrollit për të verifikuar administrimin korrekt të fondeve. Secili zjarrfikës duhet të sigurohet.

6.11 Rregulloret

Sipas ekspertëve të CTIF-së ligjet e aplikueshme krijojnë një kornizë të mirë për shërbimin zjarrfikës në Kosovë, por i referohen së tepërmi detajeve të imëta. Si rezultat i kësaj janë vërejtur mospërputhshmëri të mëdha në mes të ligjeve dhe realitetit. Për më tepër ekspertët kanë mësuar se nuk ekziston asnjë procedurë standarde operative dhe se standardet që kanë të bëjnë madhësinë e brigadave zjarrfikëse janë të paqarta dhe janë në zhvillim e sipër. Deri më tani rregulloret e shkruara para vitit 1999 janë bazë për numrin e zjarrfikësve në stacione. Numri ekzistues dhe llojet e ndryshme të automjeteve zjarrfikësve për një stacion janë si rezultat i historisë të tetë viteve të fundit.

Rregullore e shkruar për:	Po/Jo	Vërejtje
Numrin i personelit për stacion	Jo	Asnjë hollësi e dhënë nga DME-ja
Numrin i njësive për stacion	Jo	Asnjë hollësi e dhënë nga DME-ja
Llojin e njësive për stacion	Jo	Asnjë hollësi e dhënë nga DME-ja
Edukimin e kërkuar	Jo	Asnjë hollësi e dhënë nga DME-ja
Numrin e stacioneve për qytet	Jo	Asnjë hollësi e dhënë nga DME-ja
Kohën e reagimit	Jo	Asnjë hollësi e dhënë nga DME-ja

Fig. 6: Dëshmi që tregojnë se nuk ekzistojnë rregullore të shkruara që përcaktojnë shërbimin zjarrfikës. Për zhvillimin e shërbimit zjarrfikës drejt standardeve të EU-së, këto rregullore të shkruara janë të domosdoshme.

Në sistemin e tanishëm të shërbimit zjarrfikës në Kosovë, ofrohen të dhëna vetëm mbi kohën e përgatitjes (intervali nga alarmimi i stacionit zjarrfikës deri tek nisja për në vendin e ngjarjes).

Standardet	Po/Jo	Vërejtje
Koha e përgatitjes	Po	30 sekonda gjatë ditës dhe 45-110 sekonda gjatë natës
Numri i zjarrfikësve për thirrje	Jo	Jo më pak se 3 zjarrfikës për automjet
Ndarja e zonës së përgjegjësive e cila duhet të arrihet brenda kohës së caktuar	Jo	Standarde të tilla janë të panjohura
Standardet tjera	Jo	Nuk ka informata të mëtutjeshme

Fig. 7: Të dhënat për standardet ekzistuese në shërbimin për zjarrfikje dhe shpëtim të Kosovës

Para-pjesëmarrja për shërbimin zjarrfikës është rregullore e shkruar për llojin dhe numrin e njësive zjarrfikëse në bazë të aktiviteteve të ndryshme operative. Në stacion përkatës, para-pjesëmarrja është e krijuar nga vetë stacioni në fjalë dhe varet nga numri i automjeteve dhe

zjarrfikësve për ndërrim. Në Kosovë për thirrjet e caktuara nuk ekzistojnë rregullore standarde për strukturën, llojin dhe numrin e automjeteve zjarrfikëse (përfshirë numrin minimal të personelit për automjet). Rregullore të këtilla janë urgjentisht të nevojshme për të ofruar një shërbim të kualitetit të mirë dhe për të qenë në gjendje për të operuar në mënyrë profesionale dhe të sigurt gjatë operacioneve të ndryshme të zjarrfikjes dhe shpëtimit.

Para-pjesëmarrja	Po/Jo	Vërejtje
Zjarr	JO	Kur dihet adresa e vendit të ngjarjes dhe informatat tjera shtesë për llojin e zjarrit atëherë stacioni zjarrfikës cakton para-pjesëmarrjen sipas nevojës
Shpëtim	JO	Kur dihet adresa e vendit të ngjarjes dhe informatat tjera shtesë të llojit të operacionit për shpëtim (aksidentet e trafikut rrugor, asistenca teknike, shpëtimi nga uji apo malet), atëherë stacioni zjarrfikës cakton para-pjesëmarrjen sipas nevojës
Të tjera	JO	Thirrjet tjera (materiet e rrezikshme, aksidente me materie kimike, aksidentet natyrore, etj.) nuk mund të specifikohen.

Fig. 8: Mungesa e standardeve për para-pjesëmarrje

Rekomandim: Ekspertët e CTIF-së rekomandojnë rregullimin me udhëzim administrativ të detajeve specifike siç janë koha e përgatitjes, personeli në gatishmëri dhe para-pjesëmarrja. Shërbimi për zjarrfikje dhe shpëtim duhet të punojë me qëllim të përmbushjes së kërkesave që vijnë nga ligjet dhe udhëzimet administrative. Këto udhëzime administrative dhe procedura standarde operative duhet të krijohen sa më shpejt që është e mundur.

6.12 Bashkëpunimi me agjensionet tjera të sigurisë publike në Kosovë

Në përgjithësi bashkëpunimi është i mirë. Megjithatë shërbimi i ambulancave në Kosovë duket se është pa ndonjë standard të arsyeshëm. Sa i përket bashkëpunimit me policinë, disa brigada zjarrfikëse kanë dëshirë që ky bashkëpunim të përmirësohet. Ata kanë thënë që bashkëpunimi me Trupat Mbrojtëse të Kosovës është i mirë, por në disa raste duhet shumë kohë për ti alarmuar ata. Mungon sistemi i zakonshëm i komunikimit me radio midis këtyre shërbimeve.

Rekomandim: Ekspertët e CTIF-së rekomandojnë që komunikimet në mes të gjitha agjensioneve duhet të përmirësohen në mënyrë drastike. Duhet të krijohet një strukturë komanduese gjatë aksidenteve. Shërbimi i ambulancës mund të jetë çështje për analizim nga ekspertë tjerë. Integrimi në shërbimin zjarrfikës i auto ambulancave duhet të konsiderohet si një opsion i mundshëm. Krijimi i një sistemi të komunikimit të dyanshëm duhet të jetë një çështje për shqyrtim të mëtejshëm.

6.13 Të ndryshme

- Parandalimi i zjarrit: Ekspertët e CTIF-së disa herë kanë hasur në shembuj të një pune të mirë mbrojtëse, duke përfshirë këtu inspektimet për zjarr dhe edukimin publik. Parandalimi nuk ka qenë temë kryesore e këtij hulumtimi. Megjithatë përmirësimi në parandalimin e zjarrit do të bëhet nevojë e rëndësishme posa të hapen bizneset e reja private në Kosovë nga kompanitë e ndryshme përfshirë këtu edhe hotelet.
- Planet emergjente komunale: Në asnjë rast komandantët e stacioneve nuk u janë referuar këtyre planeve edhe pse ato kërkohen më ligj.
- Organizimi i shërbimeve: Transferimi i brigadave zjarrfikëse tek komunat në vitin 2004 ka dështuar dhe kjo ka rezultuar në gjendje jo të barabartë të këtyre brigadave në tërësi

Kosovën. Treguesit kryesor të këtij dështimi janë fondet jo adekuate, procedurat jo të qarta për alarmim si dhe paqartësia rreth kryesimit të komandës në rast të aksidenteve.

- Sistemi i raportimit: Zyrtarë të disa stacioneve deklarojnë se ata përgatisin përmbledhje sa i përket kohës së përgatitjes/intervenimeve të tyre dhe u dërgojnë raporte mujore komunës përkatëse dhe DME-së. Në disa stacione librat që përmbajnë format e caktuara me të dhëna bazike për kohën e përgatitjes/intervenimeve janë të plotësuar.
- Statistikat: Ekipi ka vërejtur të dhëna statistikore të pamjaftueshme sa i përket numrit dhe llojit të kohës së përgatitjes/intervenimeve. Vetëm një brigadë zjarrfikëse është hasur e cila ka bërë raport vjetor me statistika të hollësishme.
- Ekspertët e CTIF-së kanë pasur qasje në statistikën e Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave, por këto statistika nuk kanë qenë të kompletuara dhe të besueshme sepse disa komandantë të stacioneve kanë deklaruar se ata nuk i raportojnë DME-së në mënyrë të rregullt.

Rekomandim: Ekspertët e CTIF-së këshillojnë Departamentin për Menaxhimin e Emergjencave të krijojë një grup pune i cili do të punonte në zgjidhjen e vërejtjeve të ndryshme. Po ashtu rekomandohet që të shqyrtohet sërish ri-centralizimi.




Fig. 9: Problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet shërbimi për zjarrfikje dhe shpëtim i Kosovës.




Fig. 10: Faktet më shqetësuese për shefin e zjarrfikësve të stacionit përkatës




Fig. 11: 'Dëshirat' e brigadave zjarrfikëse për të ardhmen

7. Propozimet për implementim

- Stacionet për zjarrfikje dhe shpëtim: Për secilin regjion radhazi, krijoni nga një komision dhe kontrolloni stacionet, ndërtesat, pajisjet dhe shënoni gjërat që nevojiten. Nevojat në qytete të mëdha mund të jenë shkallët rrotulluese, automjetet rezervë dhe rrobat për mbrojtje kimike.
- Menaxhimi i donacioneve: Krijoni një njësi për koordinim të donacioneve brenda Departamentit të Menaxhimit të Emergjencave ku do të kishte edhe personel ndërkombëtar. Kjo njësi do të pranonte vetëm donacione të cilat janë të shfrytëzueshme! Donacionet e pa shfrytëzueshme duhet të largohen nga stacionet zjarrfikëse në mënyrë që të krijohet hapësirë dhe rend.
- Qendra e trajnimit për zjarrfikje dhe shpëtim: Krijoni komisione ose grupe fokusuese të cilat përfaqësojnë të gjithë partnerët p.sh. zyrtarë nga DME-ja, brigadat zjarrfikëse, zjarrfikësit dhe zyrtarët komunal. Personeli ndërkombëtar duhet të mbështes qendrën e trajnimit në mënyrë që të arrihen standardet ndërkombëtare.
- Plani emergjent komunal: Krijoni “Inspektorët zjarrfikës rajonal” të cilët drejtojnë dhe kontrollojnë stacionet zjarrfikëse dhe u ndihmojnë komunave në vlerësimin e rrezikut dhe rreth planifikimit emergjent.
- Raportimi dhe statistikat: Krijoni komisione ose grupe fokusuese të cilat i përfaqësojnë të gjithë partnerët p.sh. zyrtarë nga DME-ja, brigadat zjarrfikëse, zjarrfikësit dhe zyrtarët komunal që të vendosin rreth nivelit të raportimit tek DME-ja dhe nevojës për statistika.

8. Lista e anekseve (vetëm si dokumente elektronike)

1	Laplje Selo/Llapplassellë	17	Zubin Potok
2	Štrpce/Shtërpçë	18	Mitrovicë/Mitrovica Jugore
3	Podujevë/Podujevo	19	Skenderaj/Srbica
4	Prishtinë/Priština 1	20	Vushtrri/Vučitrn
5	Prishtinë/Priština 2	21	Dragash/Dragaš
6	Ferizaj/Uroševac	22	Istog/Istok
7	Lipjan/Lipljan	23	Deçan/Dečani
8	Viti/Vitina	24	Pejë/Peć
9	Suharekë/Suva Reka	25	Glogovac/Glogovac
10	Gjakovë/Đakovica	26	Gjilan/Gnjilane
11	Rahovec/Orahovac	27	Kamenicë/Kamenica
12	Prizren	28	Novobërdë/Novo Brdo
13	Klinë/Klina	29	Fushë Kosovë/Kosovo Polje
14	Shtime/Štimlje	30	Automjetet
15	Malishevë/Mališevo	31	Qendra e Trajnimit
16	Kaçanik/Kačanik	32	Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave

9. Shënimet për autorin

Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Departamenti i saj për Siguri Publike në Vushtrri/Vučitrn kanë iniciuar dhe menaxhuar projektin: 'Analizimi i gjendjes - Shërbimi për Zjarrfikje dhe Shpëtim në Kosovë'. OSBE-ja ka ftuar ekspertët nga CTIF-ja (Asociacioni Ndërkombëtar për Zjarrfikje dhe Shpëtim) të cilët kanë kryer analizën. Autorët marrin përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e raportit dhe të anekseve.

I tërë materiali është krijuar nga ekipi i ekspertëve të CTIF-së në bashkëpunim me Departamentin e OSBE-së për Siguri Publike.

Ekipi i ekspertëve të CTIF-së:

Z. Tommy Forsberg/Suedi
Z. Harald Herweg/Gjermani
Z. Peter Hofman-Bang/Danimarkë
Dr. Peter Wagner/Gjermani

OSBE DSP, udhëheqësit e projektit:

Z. Heinz Schneider

OSBE DSP, asistentët e programit:

Znj. Valmira Bimbashi
Z. Visar Bivolaku
Z. Xhevdet Merovci
Znj. Shpresa Mulliqi

Falënderime të posaçme:

Z. Carsten Twelmeier, Drejtor i DSP-së pranë OSBE-së
Znj. Angela Tenbruck OSBE, DSP
Z. Bislum Zyrapi, Drejtor i DME-së
Znj. Cornelia Andree, CTIF
Z. Nexhat Behrami, DME
Z. Ibrahim Musliu, DME

Fotografitë:

CTIF-ja në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë

Detajet kontaktuese:

Misioni i OSBE-së në Kosovë, Zyra për shtyp dhe informim
press.omik@osce.org

Vërejtje

Të dhënat të cilat gjenden në raport dhe anekse janë për qëllim informimi të përgjithshëm dhe janë ofruar nga OSBE-ja. Përkundër qëllimit tonë që këto informata të jenë të freskëta dhe të sakta, ne nuk përfaqësojmë ose justifikojmë, shprehim ose nënkuptojmë rreth tërësisë, saktësisë, sigurisë, përshtatshmërisë ose disponueshmërisë në respekt të informatave që ndodhen në raport dhe anekse. Çdo mbështetje në këto informata varet nga gjykimi juaj.

E drejta e autorit

Ky raport së bashku me anekset dhe përmbajtja e tij është e drejtë e OSBE-së - © OSBE 2008. OSBE/DSP-në duhet konsideruar si burim informatash kur përdoret ky raport dhe anekset e tij.